



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1129/12 prot.

Datë 02.06.2026

**V E N D I M**  
**Nr.740/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 02.06.2026 me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75980-02-12-2026, me objekt: Loti 2 : “Riparimi dhe mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Durrës”, me fond limit 13,998,230.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me adresë: Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Alstezo” SHPK me NIPT J63208420N dhe adresë: Lagjia Kryengritja e Fierit, Fier.

**Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF me NIPT L12407012R dhe adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km.5 Kashar, Godine një kateshe përballë QTU-se. Zona Kadastrale Nr 2679 Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.5. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75980-02-12-2026, me objekt “Loti 2 : “Riparimi dhe mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Durrës” me fond limit: 13,998,230.00 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 17.03.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 30.03.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|             |                 |             |             |
|-------------|-----------------|-------------|-------------|
| Besnik Meçi | 11,855,520 lekë | 293,40 pikë | Kualifikuar |
| Alstezo     | 13,960,000 lekë | 264 pikë    | Kualifikuar |

II.4 Në datën 07.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 10.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6518 si dhe nr. Protokoli 1129/2026 datë 14.04.2026 i operatorit ekonomik “Alstezo” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75980-02-12-2026, me objekt: Loti 2 : “Riparimi dhe mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Durrës”, me fond limit 13,998,230.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1129/1 prot, datë 15.04.2026.

II.7 Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 2036 prot., datë 23.04.2026, protokolluar me tonën me nr.1129/2 prot., datë 27.04.2026, ka dërguar vendimin e KSHA nr.60/2026, datë 23.04.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Alstezo” SHPK. Referuar vendimit 60/2026, datë 23.04.2026 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.8 Me shkresën nr.1129/3 prot., datë 30.04.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacion KPP-së...*” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “*..autoriteti kontraktor duhet të dërgojë të plotë kopje të njëzuar me origjinalin të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari*

*përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sa i takon plotësimit të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 9, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”/ 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika 2.3.2.”.*

II.9. Njëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën nr.2036/2 prot., datë 04.05.2026 me objekt “Dërgim dokumentacioni bazuar në shkresën nr.1129/3 prot., datë 30.04.2026”, protokolluar me tonën me nr.1129/4 prot., datë 06.05.2026, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e operatorit ekonomik të shpallur fitues “Besnik Meci” PF.

II.10.Me shkresën nr.1129/5 prot., datë 13.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua me kërkesë Institutit Profesional ATC duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

*[...]Përfundimi i kursit për “Autoservis” dhe pajisja e individit me certifikatën përkatëse, në cilat profile e certifikon kursantin, referuar Ligjit Nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë [...].*

II.11.Me shkresën nr.1129/6 prot., datë 13.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua me kërkesë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Durrës duke i kërkuar informacionin si më poshtë:

*[...] Përfundimi i kursit për “Shërbim automobilash” dhe pajisja e kursantit me dëshminë përkatëse, në cilat profile e certifikon kursantin, referuar Ligjit Nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.*

II.12. Me shkresën nr.1129/7 prot., datë 13.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik ka vënë në dijeni palët se për shkaqe të nevojshme për verifikim, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.13.Me shkresën e datës 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1129/8 prot., datë 25.05.2026, Institutit Profesional ATC ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, e konkretisht: *[...] Kursi profesional Autoservis është një kurs profesional me një kohëzgjatje prej 460 orë mësimore që zhvillohen në laboratorët tona të autoservisit dhe praktikë profesionale. Programi përmban 3 module, Motorrist, Xhenerik, Elektroauto. [...].*

II.14.Me shkresën nr.1043 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1129/9 prot., datë 25.05.2026 Qendra e Formimit Profesional Durrës ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, e konkretisht: *[...] Kursi "Shërbim Automobilash", është ofruar nga QFP, Durrës, në përputhje me kurrikulën (programin) e disponueshëm në atë kohë. Çdo kursant që ka ndjekur apo ndjek një kurs dhe pasi i nënshtrohet Provimit Përfundimtar Teoriko - Praktik, certifikohet;referuar Ligjit Nr.15/2017, datë 16/02/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", do të thotë që:*

*kursanti përfiton një seri njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat I mundësojnë atij ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional.*

*Në këtë kuptim:*

*kursanti që është çertifikuar në kursin Shërbim automobilash, ka fituar njohuri dhe aftësi, jo vetëm në njohjen, matjet dhe diagnostifikimin e problemeve mekanike në automjet, por edhe në Përzgjedhjen e materialeve zëvendësuese dhe në kryerjen e shërbimeve kryesore në automjet Njohjen dhe kryerjen e shërbimeve në sistemin e komandimit*

*Shërbimet në kavot dhe cilindrat e friksionit*

*Shërbimet në transmesionin kryesor dhe diferenciali*

*Shërbimet në gjysmëboshtet dhe grushtet në automjet*

*Shërbimet në pompën e frenave*

*Shërbimet në cilindrat dhe tamburet*

*Shërbimet në cilindrat e frenave me disk*

*Shërbimet në motorinot dhe alternatorët (dinamoja)*

*Shërbimet në elementet e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.[...].*

II.15. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF *me arsyen se nuk plotëson kriterin 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta për kualifikim” pika 2.3 Kapaciteti teknik,, pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë përmbushjen e kriterit si më poshtë:

2.3.2 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 7 (shtatë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

*a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.*

*b) 1 (një) motorrist*

c) 2 (dy) xhenerikë

d) 1 (një) pompist

e) 1 (një) elektroauto

f) 1 (një) bojaxhi - llamarinist

Në lidhje me punonjës në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e, f, më sipër duhet të paraqitet:

kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto, bojaxhi-llamarinist dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Auto Manoku Servis shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 10 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" , sipas së cilës në Pjesën e III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B Deklaratë, Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme(nëse kërkohen), operatori ekonomik "Besnik Meçi" PF deklaron, si më poshtë:

**B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

| Deklarata                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Përgjigje                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:<br><br>Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor. | <u>Punonjës</u><br><br>Po [X] Jo [ ]<br><br>Nëse, po, numri i punonjësve:<br><br><u>Numri mesatar i punonjesve 13</u><br><br>Profili i punonjësve<br><br><b>OE: DBD Group/Besnik Meçi ka të punësuar punonjës të specializuar, të kualifikuar, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate si më poshtë vijon:</b> |

1(një) përgjegjës Teknik- Inxhinier mekanik, 1(një) motorrist 2 (dy) xhenerikë 1 (një) pompist 1 (një) elektroauto 1 (një) bojaxhi – Ilamarinist, Etj...

Te gjith punonjesit e lartepemendur me kontratat e punes, deshmit/ certifikatat/diploma, dhe janë në formularët E-SIG të konfirmuar nga organet kompetente, sipas ligjit ne RSH.

Makineri e mjete

Po [X] Jo [ ]

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,**

**formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këtë rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

**h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);**

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

**6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike.**

Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij .

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.7. Në ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij përcakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka për mision: a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e

*tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare; c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.”* .

Ndërsa në pikën 17 të nenit 4 të po këtij ligji parashikohet se: *“Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar”*.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.3.8. Referuar kriterit 2.3.2, në lidhje me disponimin e personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, Komisioni konstaton, se kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe dorëzimit të dokumentave si kontratat e punës dhe dëshmitë e aftësisë profesionale për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Për plotësimin e kriterit në lidhje me disponimin e personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, operatori ekonomik "Besnik Meçi" PF ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në pjesën e tretë të tij *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B Deklaratë "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)"*, ka deklaruar punonjësit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, sikurse pasqyrohet në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Referuar kriterit të sipërcituar dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar punonjësit në përputhje me kriterin e kualifikimit.

III.1.9.Me qëllim shqyrtimin e ankesës së paraqitur dhe shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, mbi verifikimin e dokumentacionit kualifikues, në mbështetje të vetëdeklarimeve të paraqitura nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, si ofertues i renditur në vend të parë në procedurën e prokurimit objekt anikimi, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën 1129/3 prot., datë 30.04.2026, me objekt “*Mbi detyrimin e autoriteti kontraktor për dhënie informacion KPP-së...*” Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion me përmbajtje si vijon: “*..autoriteti kontraktor duhet të dërgojë të plotë kopje të njësuar me origjinalin të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF pranë autoritetit kontraktor si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sa i takon plotësimit të kriterit të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 9, “Formular i kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit”/ 2. Kriteret e Veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika 2.3.2.*”

Autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.2036/2 prot., datë 04.05.2026 me objekt “*Dërgim dokumentacioni bazuar në shkresën nr.1129/3 prot., datë 30.04.2026*”, protokolluar me tonën me nr.1129/4 prot., datë 06.05.2026, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin fizik të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF.

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur si më sipër cituar, si dhe nisur nga pretendimet e ankimesit sa i takon kontratave të punës së punonjësve A.K.O.D B.M, si dhe dëshmime të kualifikimit për këta punonjës, konstatohet se nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF, është dorëzuar në përmbushje të kriterit 2.3.2 dokumentacioni i poshtëshënuar:

Për punonjësin me profil **elektroauto** është paraqitur Kontratë pune, datë 08.09.2025, midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z.A.K, me detyrën “Elektroauto automjetesh”, kohëzgjatja me afat të pacaktuar; Diplomë Profesionale në “Teknologji Automjetesh”, në emër të Z. A.K, për përfundimin me sukses të studimeve profesionale të larta, me kohë të plotë, lëshuar nga Kolegji Profesional i Tiranës.

Për punonjësin me profil **motorrist** është paraqitur Kontratë pune, datë 08.09.2025 midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z.O.D, me detyrën “Mekanik - Motorrist”, kohëzgjatja me afat të pacaktuar; Certifikatë për përfundimin e kursit profesional për “Autoservis”, në emër të Z.O.,D, lëshuar nga Instituti Profesional ATC.

Për punonjësin me profil **xhenerik, bojaxhi-llamarinist** është paraqitur Kontratë pune, datë 08.09.2025 midis punëdhënësit “DBD Group/ Besnik Meçi” si dhe Punëmarrësit Z. B.M me detyrën “Shërbim automjetesh – Xhenerik, Bojaxhi-Lllamarinist”, kohëzgjatja me afat të pacaktuar; Dëshmi Kualifikimi për mbarimin e kursit “Shërbim Automobilash”, në emër të z. B.M, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës; Sikkens Certificate, Mr.B.M, successfully attended the course “Sikkens Professional Spraying Techniques”, held in Zalec, Slovenia, 6-9.12.2022;

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Alstezo” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” P.F me arsyen se: *...në lidhje me profesionin xhenerik ka paraqitur një certifikatë lëshuar nga Instituti profesional ATC , i cili ka përfunduar kursin*

profesional për “Shërbim automjetesh”. Sikurse duket, në këtë rast në dokumentacionin e paraqitur nga OE Besnik Meçi p.f. mungon profili i profesionit Xhenerik (per te cilin ne kontrate thuhet se eshte kualifikuar ) profil i cili eshte kerkuar nga AK ne piken 2.3.2 , Shtojca 9 ne DT, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 sa i takon certifikimit të punonjësit me profil xhenerik, ka paraqitur Dëshmi Kualifikimi për mbarimin e kursit “Shërbim Automobilash”, në emër të z. B.M, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Besnik Meci” PF, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr.1129/6 prot., datë 13.05.2026, ju drejtua me kërkesë autoritetit që ka lëshuar certifikatën, Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Durrës, duke i kërkuar informacionin si më poshtë: [...] Përfundimi i kursit për “Shërbim automobilash” dhe pajisja e kursantit me dëshminë përkatëse, në cilat profile e certifikon kursantin, referuar Ligjit Nr.15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Me shkresën nr.1043 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1129/9 prot., datë 25.05.2026 Qendra e Formimit Profesional Durrës ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar, e konkretisht: [...] Kursi "Shërbim Automobilash", është ofruar nga QFP, Durrës, në përputhje me kurrikulën (programin) e disponueshëm në atë kohë. Çdo kursant që ka ndjekur apo ndjek një kurs dhe pasi i nënshtrohet Provimit Përfundimtar Teoriko - Praktik, certifikohet; referuar Ligjit Nr.15/2017, datë 16/02/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", do të thotë që: kursanti përfiton një seri njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat i mundësojnë atij ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional. Në këtë kuptim: kursanti që është çertifikuar në kursin Shërbim automobilash, ka fituar njohuri dhe aftësi, jo vetëm në njohjen, matjet dhe diagnostifikimin e problemeve mekanike në automjet, por edhe në

Përzgjedhjen e materialeve zëvendësuese dhe në kryerjen e shërbimeve kryesore në automjet  
Njohjen dhe kryerjen e shërbimeve në systemin e komandimit

Shërbimet në kavot dhe cilindrat e friksionit

Shërbimet në transmesionin kryesor dhe diferenciali

Shërbimet në gjysmëboshtet dhe grushtet në automjet

Shërbimet në pompën e frenave

Shërbimet në cilindrat dhe tamburet

Shërbimet në cilindrat e frenave me disk

Shërbimet në motorinot dhe alternatorët (dinamoja)

Shërbimet në elementet e sistemit të ndriçim-sinjalizimit.[...].

Referuar përgjigjes së Qendrës së Formimit Profesional Durrës Komisioni vlerëson se, dokumenti Dëshmi kualifikimi në emër të Z.Besnik Meçi, për mbarimin e kursit “Shërbim automobilash”, paraqitur nga operatori ekonomik “Besnik Meçi” PF në funksion të dëshmisë së aftësisë profesionale sipas ligjit 15/2017 “Mbi arsimin dhe fomimin professional”, i ndryshuar, për profilin xhenerik është sipas kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor e për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur vërteton, se punonjësi Besnik Meçi, disponon kualifikimin përkatës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” P.F me arsyen se *certifikata e paraqitur nga OE Besnik Meçi nuk përbën dëshmi të vlefshme të aftësisë profesionale për bojaxhiun sipas pikës 2.3.2 dhe sipas Ligjit 15/2017...* Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 sa i takon certifikimit të punonjësit me profil *bojaxhi*, referuar deklaramit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka paraqitur certifikatë nga Sikkens, AkzoNobel, Slloveni për z. Besnik Meçi. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se certifikata e lëshuar nga Sikkens për punonjës B.M nuk hyn në kuadrin rregullator të Ligjit nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional*”, pasi ky institucion nuk funksionon si ofrues i licencuar i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri. Në dokumentat standarte të tenderit është kërkuar shprehimisht që për punonjës me profil *bojaxhi* kërkohet Dëshmi e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, “*Mbi arsimin dhe formimin profesional*”, i ndryshuar. Sipas Ligjit nr. 15/2017, certifikatat zyrtare të formimit profesional lëshohen vetëm nga ofrues (shkolla ose qendra të formimit profesional) që janë të licencuara nga ministria përgjegjëse dhe të miratuara nga AKAFPK dhe AKPA. Këto certifikata lidhen me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Referuar certifikatës së dorëzuar nga operatori ekonomik Besnik Meci, si dëshmi për 1 punonjës me profil *bojaxhi* si dhe kriterit 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky operator ekonomik nëpërmjet certifikatës së dorëzuar nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pikën 2.3.2 të shtojcës 9, të dokumentave të tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SHPK., për skualifikimin e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Besnik Meçi” PF referuar arsyetimit të bërë në pikën III.1.9 të këtij vendimi do të ndryshojë nga e kualifikuar në të skualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik*

*gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” SHPK në procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75980-02-12-2026, me objekt: Loti 2 : “Riparimi dhe mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Durrës”, me fond limit 13,998,230.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
  2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Besnik Meçi” PF sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Alstezo” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

